

VENDIM
Nr.385, datë 6.7.1998

**PËR MIRATIMIN E RELACIONIT PËRFUNDIMTAR TË KOMISIONIT PARLAMENTAR
TË HETIMIT TË NGJARJEVE QË KANË NDODHUR NË SHQIPËRI NË PERIUDHËN
JANAR- QERSHOR**

Në mbështetje të nenit 20 të ligjit nr.8521, datë 22.10.1997 “Për Komisionin Parlamentar të hetimit të Ngjarjeve që kanë ndodhur në Shqipëri në periudhën janar-qershor të vitit 1997”

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

1. Miratohet relacioni përfundimtar i Komisionit Parlamentar të Hetimit të Ngjarjeve që kanë ndodhur në Shqipëri në periudhën janar-qershor të vitit 1997, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Miratohen të gjitha propozimet e komisionit për çështjet që duhen t’i kalojnë për ndjekje organeve të prokurorisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.